

VENDIM
Nr. 553, datë 27.7.2016

**PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË
KOMISIONIT TË AUTORIZIMIT TË PRODUKTEVE BIOCID**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 14, të ligjit nr. 95/2015, "Për shërbimet dhe produktet biocide", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide, me këtë përbërje:
- a) Drejtori i Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë kryetar;
 - b) Një përfaqësues nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor anëtar;
 - c) Një përfaqësues nga Instituti i Shëndetit Publik anëtar;
 - ç) Një përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit anëtar;
 - d) Një specialist të kualifikuar, në një nga fushat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 95/2015, të përzgjedhur nga ministri i Shëndetësisë anëtar.

Të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", në pikën 1, të këtij vendimi, duhet të kenë kualifikimin e përcaktuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 95/2015.

2. Komisioni i Autorizimit të Produkteve Biocide, në varësi të problematikës që do të shqyrtohet në mbledhje, thërret ekspertë edhe nga fusha të tjera.

3. Komisioni i Autorizimit të Produkteve Biocide është organ teknik, këshillimor, i cili:

- a) mbështet autoritetin kompetent për hartimin e politikave për shërbimin biocid në shëndetin publik;
- b) rekomandon, sipas rastit, lëshimin apo refuzimin e aktit të autorizimit dhe vendosjen në treg të produkteve biocide;
- c) rekomandon ndalimin apo kufizimin e përdorimit të produkteve biocide;
- ç) rekomandon përcaktimin e formulimit kuadër të produkteve biocide.

4. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi në fushën e produkteve biocide. Ata, paraprakisht, duhet të deklarojnë marrë-dhëniet, nëse kanë, me subjektet e importimit ose të tregtimit të produkteve biocide.

5. Sekretariati i Autorizimit të Produkteve Biocide është edhe sekretariat i Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide. Përbërja e tij përcaktohet nga ministri i Shëndetësisë, brenda strukturës dhe organikës së Ministrisë së Shëndetësisë.

6. Komisioni i Autorizimit të Produkteve Biocide, si rregull, mbledhet një herë në 2 (dy) muaj, sipas njoftimit të kryetarit, dhe mbledhjet zhvillohen me jo më pak se 2/3 e anëtarëve. Njoftimi, ku përcaktohen rendi i ditës dhe materialet që do të diskutohen në mbledhje, u dërgohet anëtarëve të komisionit, të paktën, 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhje.

7. Vendimet për dhënien e rekomandimeve për autoritetin kompetent merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

8. Komisioni i Autorizimit të Produkteve Biocide thirret nga kryetari. Kur një anëtar nuk merr pjesë në tri mbledhje radhazi, përjashtohet, me vendim të kryetarit të Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide dhe zëvendësohet nga institucioni përkatës.

9. Mbledhjet e Komisionit të Autorizimit të Produkteve Biocide drejtohen nga kryetari dhe, në mungesë të tij, vetë kryetari cakton një anëtar të komisionit për drejtimin e mbledhjes.

10. Procesverbal për çdo mbledhje mbahet nga personi i caktuar nga Sekretariati i Autorizimit të Produkteve Biocide, i cili merr pjesë rregullisht në çdo mbledhje të zhvilluar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama